



STAMP

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALIQ  
DREJTORIA E SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR  
SEKTORI I SHËRBIMEVE SHOQËRORE DHE STREHIMIT

Nr. 661 Prot

Maliq, më 22.2.2021

LËNDA: Për shpallje.

**NJËSISË ADMINISTRATIVE: MALIQ, POJAN, LIBONIK, PIRG, VRESHTAS, GORË,  
MOGLICË.**

**NJOFTIM**

Në mbështetje të ligjit nr.22/2018, VKM nr. 454 datë 3.7.2019 si dhe VKM nr.384 datë 12.6.2019, njoftojmë qytetarët e Bashkisë Maliq, që jetojnë në banesa të amortizuara apo në rrezik shëmbje, se kanë filluar rregjistrimet për programin e “Përmirësimit të kushteve të banimit për kategoritë e pa favorizuara”. Familjet duhet të paraqiten pranë sektorit të strehimit Bashkia Maliq, përpara datës 15 Shkurt, nga e hëna në të premte, ora 9<sup>00</sup>-12<sup>00</sup>.

Përfituesit nga programi i përmirësimit të kushteve të banimit.

Ligji 22/2018 Neni 43:

1. Nga programi i përmirësimit të kushteve të banimit, si dhe përmirësimit deri në ndërtim të ri përfitojnë familjet/individët, të cilëve u mungon një strehim i përshtatshëm.

2. Përparësi në trajtimin me këtë program kanë:


- a) personat me aftësi të kufizuara;
- b) individët me statusin e jetimit;
- c) familjet e policëve të rënë në detyrë;
- ç) të moshuarit;
- d) komuniteti rom;
- dh) komuniteti egjiptian;
- e) komunitetet e zonave rurale; (familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike);
- ë) prindërit e vetëm;
- f) viktima të trafikimit /viktima të mundshme të trafikimit;
- g) viktima të dhunës në familje.

Familjet të cilat plotësojnë kushtet e mësipërme, duhet të bëjnë kërkesën për aplikim duke dorëzuar foto të objektit si dhe dokumentacionin ligjor për pronësinë e banesës (Certifikatë pronësie, Legalizimi).

Aplikimet mund të dërgohen edhe në mënyrë elektronike në adresën e email të poshtë shënuar, formulari mund të shkarkohet ne <https://www.bashkiamaliq.gov.al/>, email: [ledionm@yahoo.it](mailto:ledionm@yahoo.it).

**KRYETARI I BASHKISË  
Gëzim TOPÇIU**

**ME URDHËR DHE ME POROSI  
ZV/KRYETARI  
Eridjon Rustemi**



Adresa: Bulevardi “Rinia”, Maliq, Korçë

Tel. & Fax. 0861 2 2026

[www.bashkiamaliq.gov.al](http://www.bashkiamaliq.gov.al)

*Nr. 19 Prot  
Dt. 19.02.2021*